



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-147

Prishtinë, më 3 mars 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 3 MARS 2014

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamit dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj,

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDI-ja: Rinor Beka.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 shkurt 2014,
2. Vazhdimi i seancës plenare, të filluar më 27 shkurt 2014,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 shkurt 2014

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 shkurt 2014.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare të mbahet më 13 mars 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Votimi i rekomandimeve të debatit parlamentar lidhur me gjendjen e sigurisë në shkollat e Republikës së Kosovë,*
2. *Votimi i rekomandimeve të debatit parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë,*
3. *Votimi i rekomandimeve të debatit parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të IGK "Ballkan", në Suharekë.*
4. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
5. *Koha për pyetje parlamentare,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e Maturës Shtetërore,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,*
8. *Emërimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit,*
9. *Zgjedhja e Avokatit të Popullit,*
10. *Zgjedhja e një anëtari joekzekutiv në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.*

Gjithashtu, u konstatua se Kryesia në mbledhjen e saj të radhës mund ta plotësojë këtë rend dite edhe me pika të tjera, që përgatiten në ndërkohë.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Informata e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj

Kryesia, pas diskutimit lidhur me pikën e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision Funkcional, që ta shqyrtojë shkresën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për pagat e punëtorëve të Fabrikës së Gypave në Ferizaj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Pikat shtesë:

1. Procedimi i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryesia, pas diskutimit lidhur me Projektligjin e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, të hartuar nga Komisioni për Legjislacion, si dhe ta përgatisë deklaratën e ndikimit buxhetor dhe deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-në të këtij projektligji në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

2. Sqarimi shtesë i Organit të Pavarur Përzgjedhës për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Kryesia, pasi diskutoi për çështjen e lartpërmendur, këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për mbledhjen plenare të radhës që Kuvendi të deklarohej rreth propozimit të Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

3. Raporti i shpenzimeve me rastin e shënimit të 6-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2014

Kryesia u njoftua lidhur me shpenzimet e të gjitha aktiviteteve që janë organizuar nga Kuvendi, me rastin e shënimit të 6-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 shkurt 2014, të mbuluara nga buxheti i Kuvendit të Kosovës, në shumë prej 5 612,88€.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale